

Në bazë të neneve **12 (b)** e **13 (2)** të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nenit **34 (4)** të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kuvendi i Akademisë në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2006, nxjerr

R R E G U L L O R E N
MBI PROPOZIMIN DHE ZGJEDHJEN E ANËTARAVE
TË KRYESISË SË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË
ARTEVE TË KOSOVËS

Neni 1

Kryesinë e Akademisë e përbëjnë: kryetari, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë, të cilët në bazë të propozimeve të seksioneve i zgjedh Kuvendi.

Neni 2

Kandidatët për Kryesinë e Akademisë i propozojnë seksionet e Akademisë. Propozimet duhet t'i dërgohen Kryesisë së Akademisë së paku 15 ditë para mbledhjes zgjedhore të Kuvendit të Akademisë.

Neni 3

- (1) Me rastin e propozimit të anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, me vota të fshehta, secili anëtar i seksionit mund të shënojë në fletëvotim nga një kandidat për kryetar dhe nënkryetar (nga radhët e anëtarëve të rregulltë) dhe një tjetër për sekretar të përgjithshëm nga radhët e të gjithë anëtarëve të Akademisë.
- (2) Për kandidatët e propozuar, anëtarët e seksionit votojnë me vota të fshehta. Për secilin funksion konsiderohet i nominuar kandidati që i fiton shumicën e votave të anëtarëve të seksionit.
- (3) Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave, votimi përsëritet për kandidatin që ka fituar numrin më të madh të votave. Në qoftë se kandidati përsëri nuk fiton mbi gjysmën e votave të anëtarëve të seksionit, konsiderohet se seksioni

nuk ka kandidat të vetin për funksionin e caktuar në Kryesinë e Akademisë.

Neni 4

- (1) Rezultatet e kandidimit për anëtarët e Kryesisë bashkë me procesverbalet e mbledhjeve i dërgohen Kryesisë, e cila pasqyrën që i kanë arritur ua përcjell seksioneve.
- (2) Në mbështetje të kësaj pasqyre, seksionet, me vota të fshehta, do t'i përcaktojnë përfundimisht propozimet e tyre për funksione të caktuara në Kryesinë e Akademisë.

Neni 5

- (1) Kuvendi i Akademisë nga radhët e kandidatëve të propozuar nga seksionet e zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm të Akademisë.
- (2) Për kandidatët për kryetar, nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm, votohet me fletëvotime, në të cilat kandidatët renditen sipas alfabetit, ndërsa për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve votohet me fletëvotime sipas renditjes së seksioneve.
- (3) Të zgjedhur konsiderohen kandidatët që kanë fituar shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin e Kuvendit.
- (4) Nëse asnjë kandidat për funksion të caktuar nuk fiton shumicën e duhur të votave, votimi për atë funksion përsëritet vetëm për tre kandidatët që kanë fituar më shumë vota. Nëse edhe pas votimit të përsëritur asnjë kandidat nuk fiton shumicën e votave, votimi përsëritet, duke eliminuar kandidatin i cili në votimin e dytë ka fituar numrin më të vogël të votave. Në votimin që do të përsëritet, kandidatët renditen sipas numrit të votave që i kanë fituar në votimin e dytë.

Neni 6

- (1) Zgjedhja e sekretarit të seksionit është e verifikuar në qoftë se fiton shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin e Kuvendit.

- (2) Nëse kandidatët nga alineja (1) nuk verifikohen, seksionet do t'i propozojnë për seancën e ardhshme të Kuvendit kandidatë të tjerë.
- (3) Në seancën e cila do të mbahet brenda 15 ditësh, përsëritet votimi për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

**KUVENDI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE
TË KOSOVËS**

KRYETARI I AKADEMISË

Akademik Rexhep Ismajli, d.v.